

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 17/12/2018

Për: "DENIS-05" Shpk, TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Hamid Shijaku.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-91382-10-24-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i shkollës 9 – vjecare Tregtan, Has"

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.43, date 29.10.2018, Njoftim Kontrate

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët 

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "AURORA KONSTRUKSION" Shpk, NIPT-i: K02017003I

Vlera: 17,735,963.0 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh.

2. DENIS-05" Shpk, NIPT-i: K51518029B

Vlera: 20,459,845.0 (njetete milion e katerqind e pesedhjetë e nente mije e teteqind e dyzete e pese) leke pa Tvsh .

3. "ELDA-VL" Shpk, NIPT-i: K67106202W

Vlera: 0.0(zero) ka paraqitur oferte boshe

4. "KEVIN CONSTRUCTION" Shpk NIPT-i: K71401004W

Vlera: 0.0(zero) Nuk ka paraqitur oferte.

5. BO "LALA" Shpk & "ED KONSTRUKSION" Shpk, NIPT-e: J76418903B & K61625001I

Vlera: 20,459,842.0 (njetet milion e katerqind e pesedhjetë e nente mije e teteqind e dyzete e dy) leke pa Tvsh .

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "AURORA KONSTRUKSION" Shpk, NIPT-i: K02017003I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. "ELDA-VL" Shpk,

NIPT-i: K67106202W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

3. "KEVIN CONSTRUCTION" Shpk NIPT-i: K71401004W

4. BO "LALA" Shpk & "ED KONSTRUKSION" Shpk, NIPT-e: J76418903B & K61625001I

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

OE "AURORA KONSTRUKSION" Shpk

Është skualifikuar nga KVO per arsyet si me poshte:

Pas hapjes dhe vlersimit ofertave u pa që oferta e korrigjuar për shkak të gabimit llogaritjes së OE "AURORA KONSTRUKSION" Shpk në zërin "prozhektorë" ishte si më poshtë:

Sipas preventivit publikuar nga AK :

Nr.	Nr.An	Emertimi i punimeve	Njesa	Sasia	Cmimi	Vlera
25	An	Prozhektore	cope	4	18,000	72,000

Sipas Preventivit ofertues nga OE “AURORA KONSTRUKSION” Shpk

Nr.	Nr.An	Emertimi i punimeve	Njesa	Sasia	Cmimi	Vlera
25	An	Prozhektore	cope	74	18,000	1,332,000

Pas perlllogaritjeve u pa që ka ndryshime si më poshtë:

		SHUMA Pa Tvsh e publikuar (fondi Limit)				20,460,110
		SHUMA Pa Tvsh pas korigjimit ofertes				16,412,963
		SHUMA PA TVSH e ofertuar nga OE				17,735,963
		Diferenca nga: (vlera ofertuar -vleren e korigjuar)				1,323,000
		Gabimi në % (diferenca/vleren ofertuar)				7.46%

Në këto kushte, bazuar në Nenin 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike.

“Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se  $\pm 2\%$  e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”, gabimi është 7.46%

**Për këto arsye oferta Juaj nuk kualifikohet.**

#### **OE “ELDA-VL” Shpk**

Është skualifikuar nga KVO per arsyet si me poshte:

Ka paraqitur vetem ekstraktin e thjeshtë dhe formularin e ofertës (Shtojcën Nr.1) të paplotësuar-pa vlerë. Asnjë dokument tjetër kualifikues nuk është paraqitur nga OE “ELDA-VL” Shpk

**Për këto arsye oferta Juaj nuk kualifikohet.**

#### **OE “KEVIN KONSTRUKSION” Shpk**

Është skualifikuar nga KVO per arsyet si me poshte:

Nuk ka paraqitur asnjë document kualifikues sipas kerkesave te DST.

**Për këto arsye oferta Juaj nuk kualifikohet.**

#### **BO “LALA” Shpk & “ED KONSTRUKSION” Shpk**

Është skualifikuar nga KVO per arsyet si me poshte:

Operatori ekonomik “LALA” Shpk, pjesë e BO “LALA” Shpk & “ED KONSTRUKSION” Shpk, sipas akt marrveshjes të datës 23/11/2018 me nr.2431 rep., per pune te ngjashme, ka paraqitur dhe dokumentacionin për realizimin e kontratës me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit dhe Kuz te qytetit Sarande”, por nuk ka paraqitur kontraten baze te lidhur mes operatorit “Trema Engineering 2” Sh.p.k dhe Sh.A Ujesjelles Kanalizime Sarande. Formulari vleresimit nuk eshte firmosur nga Autoriteti Kontraktor, Sh.A. Ujesjelles Kanalizime Sarandë.

Nënkontraktimi bëhet vetëm me miratimin e AK, në rastin konkret nga Sh.A. Ujesjelles Kanalizime Sarandë, kjo në mbeshtetje të ligjit 9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, neni 61(Nënkontraktimi), pika 3 ku thuhet që: “Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji...”. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 75, pika 5 ku thuhet që: “Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor

një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë”.

Pra, mungon ky miratim nënkontraktimi nga AK Sh.A. Ujesjelles Kanalizime Sarandë.

OE “LALA” Shpk, pjesë e BO “LALA” Shpk & “ED KONSTRUKSION” Shpk, të datës 23/11/2018, ka paraqitur shtojcën 10, “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”. Një pjesë e mjeteve dhe pajisjeve të paraqitura për ekzekutimin e kesaj kontrate janë të deklaruara edhe në ekzekutimin e kontratës së lidhur me bashkinë Has, me object: **“Rindërtim i shkollës 9- vjeçare, fshati Letaj, Has” , datë 21/09/2018**. Në këtë mënyre OE “LALA” Shpk, bie ndesh me deklaratën e datës 26/11/2018 në të cilën thuhet që : **“Makinëritë dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata tjera...”**. Disa prej mjeteve të deklaruara në dy objektet janë: Eskavator me zinxhirë me nr shasie 4462, Eskavator me zinxhirë me nr shasie 3XK02356, Eskavator me zinxhirë me nr shasie 1XS00975, eskavator me goma me nr shasie 6679286, eskavator me goma me nr shasie 662926, etj pajisje dhe mjete.

OE “LALA” Shpk, pjesë e BO “LALA” Shpk & “ED KONSTRUKSION” Shpk, të datës 23/11/2018, ka paraqitur si pjesë të stafit **Urbanist Goxho Xhelili**. Në fakt nga verifikimi i dokumentacionit vertetohet që kontrata e lidhur mes OE LALA Shpk dhe z. Goxho Xhelili, si dhe kontrolli i listë pagesave të 3 muajve te fundit, z. Goxho Xhelili figuron si arkitekt dhe jo urbanist ashtu si kërkohet ne DST.

OE “ED KONSTRUKSION” Shpk, pjesë e BO “LALA” Shpk & “ED KONSTRUKSION” Shpk, të datës 23/11/2018, i Mungojne kontratat me OSHEE dhe konfirmimet e pagesave te energjisë elektrike të subjektit për veprimtaritë kontraktuale të ushtruar në bashkitë Vlorë, Ura Vajguore, Kamëz.

Gjithashtu, kandidati ofertues OE “ED KONSTRUKSION” Shpk, pjesë e BO “LALA” Shpk & “ED KONSTRUKSION” Shpk, të datës 23/11/2018, duhet të kishte në stafin e tij minimumi 3 muajt e fundit 1(një) urbanist. Për të cilin, duhet të paraqitej kontrata e punës, dhe të figuronte në listëpagesa. Kjo kërkesë e DST nuk është arritur të vertetohet nga OE “ED KONSTRUKSION” Shpk, pjesë e BO.

**Për këto arsye oferta Juaj nuk kualifikohet**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“DENIS-05“ Shpk, TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Hamid Shijaku**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **20,459,845.0 (njezet milion e katerqind e pesedhjetë e nente mijë e teteqind e dyzete e pese) leke pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkia Has, Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, qyteti Krumë sigurimin e kontratës**, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5(pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar, **jo nuk eshte kerkuar**) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **[nuk ka ofertues tjetër te kualifikuar]**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10/12/2018**

Ankesa: ka ose jo. **Nuk ka ankesa**

**Titullari i autoritetit kontraktor**

**Adem LALA**